

## SKEMA E VLERËSIMIT TË TESTIT TË PROVIMIT PROFESIONAL NGA GJUHA SHQIPE DHE LETËRSIA, JANAR 2021

1. Nxënësi/nxënësja\* merr **1 pikë** nëse ka shkruar: Perelmani, gjeniu i mistershëm i matematikës
2. Është rrethuar numri 3: *me stilin publicistik – 1 pikë*
3. Nxënësi merr **1 pikë** nëse ka shkruar: E refuzoi çmimin e Institutit Amerikan Klaj/Refuzoi të pranojë çmimin prej një milion dollarësh./Zgjodhi një nga shtatë problemet mijëvjeçare të matematikës, por refuzoi ta marrë çmimin. *(dhe përgjigje të tjera të sakta)*
4. Nxënësi merr **1 pikë nëse rrethon S** dhe shkruan argumentimin: Në verën e vitit 2006, kur është vërtetuar se prova e tij është e saktë, Perelmani e fitoi medaljen e Filldsit, çmimin më të lartë në matematikë **ose ka rrethuar P** dhe ka shkruar argumentimin: Perelmani ka fituar medaljen e Filldsit, çmimin më të madh në matematikë. Mirëpo, çmimin e ka refuzuar duke thënë se Shoqata Evropiane e Matematikanëve nuk është kompetente për ta vlerësuar punën e tij, pavarësisht nëse vlerësimi është pozitiv. *(dhe përgjigje të tjera të sakta)*  
  
**Vërejtje:** Pranohet edhe nëse nxënësi nuk ka rrethuar as S dhe as P, por që nga argumentimi është e qartë se konstatimi është i saktë.
5. Nxënësi merr **1 pikë** nëse shkruan: Hipoteza e Poenkareovit
6. Është rrethuar numri 4: 2010 – **1 pikë**
7. Është rrethuar numri 2: ndërtimi në harmoni me natyrën – **1 pikë**
8. Nxënësi merr **1 pikë** nëse shkruan dy ose tri burime të ripërtëritshme të energjisë elektrike tek ne: ujërat gjeotermale, energjia e erës dhe energjia solare).
9. Është rrethuar numri 1: 1986 – **1 pikë**
10. Është rrethuar numri 2: Garazhi publik në Shtutgart – **1 pikë**

---

\*Në tekstin e mëtejshëm nxënësi

**11.** Gjithsej **3 pikë** – nxënësi merr nga **1 pikë** nëse pranë titullit të veprës letrare shkruan gjininë letrare të cilës vepra i përket:

- Bagëti e bujqësia* - gjinia lirike (**1 pikë**)
- Pas vdekjes* - gjinia dramatike (**1 pikë**)
- Gjergj Elez Alia* - gjinia epike (**1 pikë**)

**12.** Gjithsej **2 pikë**:

- A) *Këngët e Milosaos* - 1 pikë
- B) *Jeronim de Rada* - 1 pikë

**13.** Nxënësi merr **1 pikë** nëse shkruan: poeti/Milosao

**14.** Gjithsej **2 pikë**:

- A) *Rinës* - 1 pikë
- B) *Ti vështroje dhe s'kujtoje (dhe çdo varg tjetër që e dëshmon këtë)* - 1 pikë

**15.** Nxënësi merr **1 pikë** nëse shkruan: epiko - lirike

**16.** Është rrethuar numri 3: metafora - **1 pikë**

**17.** Gjithsej **3 pikë**:

A) Nxënësi merr **2 pikë** për përgjigje plotësisht të saktë:

1. etj.
2. OBSH
3. MASHT

Nxënësi merr **1 pikë** për dy përgjigje të sakta.

Nxënësi merr **0 pikë** për një apo asnjë përgjigje të saktë.

B) Nxënësi merr **1 pikë** nëse shkruan:

Shtatëqind e shtatëmbëdhjetë

**18.** Nxënësi merr **1 pikë** nëse shkruan titullin, emrin dhe mbiemrin e autorit të veprës: *Bardha e Tamalit, Pashko Vasa*

**19.** Nxënësi merr **1 pikë** nëse shkruan: Motivi i vrasjes së Bardhës/ hakmarrjes ndaj Bardhës... (*dhe përgjigje të tjera të sakta*)

**20.** Është rrethuar numri 3: përshkrimi - **1 pikë**

**21.** Nxënësi merr **2 pikë** për një përgjigje plotësisht të saktë:

gëzimi - rasa - rrjedhore  
- funksioni - përcaktor

Nxënësi merr **1 pikë** për një përgjigje të saktë.

**22.** Nxënësi merr **1 pikë** nëse shkruan: *Kallëzues i përbërë foljor*

**23.** Gjithsej **3 pikë**:

A) Është rrethuar numri 2: Xha Gorio – **1 pikë**

B) Nxënësi merr **1 pikë** nëse e dallon dhe e emërton saktë një lloj letrar, p.sh. *Xha Gorio* është roman/ Vetëm *Xha Gorio* i përket epikës./*Xha Gorio* është roman, kurse veprat tjera jo. *(dhe përgjigje të tjera të sakta)*.  
Për një përgjigje të plotë dhe me stil nxënësi merr **2 pikë**, p.sh. Vetëm *Xha Gorio* është roman, kurse të tjerat janë poezi të letërsisë moderne./Të gjitha veprat i përkasin poezisë, përveç *Xha Goriot* i cili i përket epikës. *(dhe përgjigje të tjera të sakta)*.

**24.** Gjithsej **2 pikë**:

A) Nxënësi merr **1 pikë** nëse shkruan: A nuk e bëre punën?/Nuk e bëre punën?/Pse nuk e bëre punën?

B) Nxënësi merr **1 pikë** nëse shkruan: budallallëqe

**25.** Nxënësi merr **1 pikë** nëse shkruan: poemë tregimtare/poemë satirike

**26.** Gjithsej **2 pikë**:

C) Nxënësi merr **1 pikë** nëse rrethon S.

D) Nxënësi merr **1 pikë** nëse e argumenton përgjigjen: Është e saktë sepse struktura mbështetet në ritmin popullor, bazuar në një rimë të puthitur pas rrokjes së gjashtë. *(dhe përgjigje të tjera të sakta)*

**27.** Gjithsej **2 pikë**:

A) Nxënësi merr **1 pikë** nëse shkruan: Djalit të shtëpisë

B) Nxënësi merr **1 pikë** nëse e argumenton përgjigjen: Është e saktë sepse struktura mbështetet në ritmin popullor, bazuar në një rimë të puthitur pas rrokjes së gjashtë. *(dhe përgjigje të tjera të sakta)*

28. Nxënësi merr **1 pikë** nëse shkruan: është' frëng i marrë, çirret e bërtet!

29. Nxënësi merr **1 pikë** nëse shkruan sinonimin: gërvishtet/griset/bërtet... (dhe përgjigje të tjera të sakta)

### 30. Skema për vlerësimin me pikë të kërkesës

Përmbajtja	Saktësia gjuhësore	Lidhshmëria	Forma grafike e tekstit
<p>Nxënësi merr <b>4 pikë</b> nëse me stil dhe saktë e ka shkruar <b>kërkesën</b> e cila përmban të gjitha të dhënat e duhura:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- dërguesin e kërkesës, datën</li> <li>- marrësin e kërkesës</li> <li>- objektin e kërkesës</li> <li>- tekstin e kërkesës</li> <li>- përshëndetjen përmbyllëse të dërguesit të kërkesës</li> </ul>	<p>Respektimi i normës gramatikore (përdorimi i drejtë i rasave, shkrimi i saktë i formave foljore, kongruencës, përdorimi i gjuhës standarde).</p> <p><b>2 pikë</b></p>	<p>Lidhshmëria e mirë në nivel të tekstit.</p> <p><b>1 pikë</b></p>	<p>Përshtatja e organizimit të përgjithshëm dhe i formës grafike të tekstit, strukturës logjike të tij (teksti i kërkesës me të gjitha të dhënat e nevojshme dhe radhitjen e saktë të tyre).</p> <p><b>1 pikë</b></p>
<p>Nxënësi merr <b>3 pikë</b> nëse me stil dhe saktë e ka shkruar <b>kërkesën</b>, por ka lënë anash pa përdorur një të dhënë e cila nuk ndikon në kuptimin e kërkesës:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- p.sh. datën</li> </ul>	<p>Respektimi i normës drejtshkrimore (shkrimi i drejtë i shkronjës së madhe, përdorimi i drejtë i shenjave të pikësimit, respektimi i rregullave të shkrimit të fjalëve bashkë dhe ndaras, zbatimi i njohurive për alternimin e zanoreve përdorimi i drejtë i zanores <i>ë</i>).</p> <p><b>2 pikë</b></p> <p><b>Gjithsej 4 pikë</b></p>		
<p>Nxënësi merr <b>2 pikë</b> nëse e ka shkruar kërkesën, por ka lënë anash pa përdorur dy të dhëna të cilat nuk ndikojnë në kuptimin e kërkesës (p.sh. datën, hollësi lidhur me ngjarjen...).</p>	<p>Respektimi i normës gramatikore me gabime të vogla (p.sh. gabimet që kanë të bëjnë me përdorimin semantik të parafjalëve <i>për</i> dhe</p>		

Përmbajtja	Saktësia gjuhësore	Lidhshmëria	Forma grafike e tekstit
<p>Nxënësi merr <b>1 pikë</b> nëse e ka shkruar kërkesën e cila nuk i ka të gjitha të dhënat e nevojshme, por ka lidhje me ngjarjen dhe është e qartë çfarë është qëllimi i kërkesës</p>	<p><i><b>mbi</b></i>, përemrit <i><b>i vet/ i tij</b></i>, përdorimi i drejtë i ndërtimeve të tipit <i><b>lidhur me këtë, duke marrë parasysh</b></i> dhe i përemrave: <i><b>që, i cili, e cila, të cilët</b></i> etj.).</p>		
<p>Nxënësi merr <b>0 pikë</b> nëse e ka shkruar kërkesën e cila nuk ka lidhje me ngjarjen ose ka shkruar një tekst i cili nuk është një kërkesë...</p>	<p><b>1 pikë</b></p> <p>Respektimi i normës drejtshkrimore me gabime të pakta ( p.sh. ndonjë mospërdorim i drejtë i shenjave të pikësimit, mosrespektimi i rregullave të shkrimit të fjalëve bashkë dhe ndaras, mospërdorimi i drejtë i zanores <i><b>ë</b></i>).</p> <p><b>1 pikë</b></p> <p><b>Gjithsej 2 pikë</b></p>		